



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 33, datë 28.05.2015

PËR

**NGRITJEN E KOMITETIT KËSHILLIMOR PËR HARTIMIN E POLITIKAVE NË
TREGUN E SIGURIMEVE**

Në zbatim të nenit 15 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bordit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurave për ngritjen e Komitetit Këshillimor të Bordit të AMF-së, me qëllim draftimin e një dokumenti të zhvillimit strategjik të tregut të sigurimeve të fokusuar kryesisht por jo vetëm në zhvillimin e tregut të sigurimeve dhe propozimin e zgjidhjeve mbi problematikat e tregut të sigurimeve, si dhe dhënien e rekomandimeve lidhur me amendimet ligjore të legjislacionit primar dhe sekondar për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike.
2. Afati kohor për realizimin e objektivave të Komitetit Këshillimor do të jetë 3 muaj nga data e vendimit të Bordit të AMF-së për ngritjen e këtij Komiteti.
3. Shpërblimi i anëtarëve të Bordit Këshillimor do të jetë sa 40% e pagës së këshilltarit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.
4. AMF do të publikojë një njoftim në faqen zyrtare të internetit për shprehjen e interesit nga ekspertë të tregut të sigurimeve për një periudhë dy javore nga dalja e këtij vendimi.
5. Bordi i AMF-së do të përzgjedhë 3 nga kandidaturat për anëtar të Bordit Këshillimor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Enkeleda SHEHI